

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
 KA JË PRAVNOSNAŽNA  
 GJYKATA THEMËLORE / OSNOVNI SUD  
 FERIZAJ I UROŠEVAC **NË EMËR TË POPULLIT**

05.10.2017

**GJYKATA THEMËLORE NË FERIZAJ**, si gjykatë e shkallës së parë penale e

përbërë nga gjyqtari Ilir Bytyqi si dhe zyrtarja ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.368-7/17 të dt. 25 Prill 2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me datën 08.09.2017, në praninë e përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Valdet Avdiu dhe të pandehurit [REDAKTUAR], të njëjtën ditë morri dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 15.09.2017, përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri [REDAKTUAR] i lindur më [REDAKTUAR], me vendbanim në Fshati [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] dhe mëna [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, pronar i NTP [REDAKTUAR], shqiptar, shtetas i R. Kosovës,

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Se me datë 24 Shkurt 2017, rreth orës 20:00, në rrugën Rexhep Bislimi në Ferizaj, duke drejtuar automjetin e markës Suzuki me tabela të regjistrimit [REDAKTUAR], ka rrezikuar trafikun publik duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, me ç'rast ka vepru në kundërshtim të dispozitës ligjore neni 46 të LSKRR-së, si dhe nuk ka respektuar shenjën Stop, me ç'rast nga pakujdesia, kur arrinë në udhëkryq nuk ndalet në shenjën Stop, kalon në shiritin qytet-ura e Gjilanit dhe me pjesën e përparme të anës së djathtë e godet në derën e shoferit automjetin e markës Pikaçp VW, me tabela të regjistrimit [REDAKTUAR], të cilën e drejtonte i dëmtuari [REDAKTUAR], i cili ishte duke qarkulluar në rrugën Rexhep Bislimi në drejtim të urës së Gjilanit, ku si pasojë e këtij aksidenti, përpos dëmeve materiale të shkaktuara në dy automjetet, lëndime trupore pëson i dëmtuari [REDAKTUAR], e që bazuar në mendimin dhe

konstatimin e ekspertit mjekoligjor të datës 13 Shkurt 2017, lëndimet e tilla paraqesin dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

**me të cilën kreu veprën penale rrezikimi trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.**

Andaj, Gjykata në bazë të nenit të sipër cekur dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 73 dhe 74 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-së, e

#### **G J Y K O N**

- **D Ë N I M M E G J O B Ë** në lartësi prej 300 /tre qind / €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi e merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.
- Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-ës, i njëjti do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 €, do të vuaj 1 /një/ ditë burgimi.
- Të dëmtuarit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] me vendbanim ne rrugën e [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.
- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzetë/ €, si dhe shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 60.88 /gjashtë dhjet euro e tetë dhjet e tetë cent/ €, në afatin prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

## Ar sy e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale te kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual dhe vendi ku është kryer ose tentohet te kryhet vepra penale.

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën e saj PP.II.nr.368-7/2017 të datës 25 Prill 2017, ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR], për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar me dt.08.09.2017 në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit, lexoj aktin akuzues, dhe gjyqtari pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, konform nenit 246 par. 4 si dhe paralajmërimit te nenit 325 par. 1 të KPPK-së, të pandehurit i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuarit [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë, i vjen keq, ndihet thellë i penduar, i kërkon falje të dëmtuarit, i premtun gjykatës se më nuk do të kryej vepra të tilla penale, e lut gjykatën që ti shqiptoj një dënim sa më të buta.

Prokurori i shtetit Valdet Avdiu, me rastin e paraqitjes së mendimit të tij, ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë për të akuzuarit.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPR-së, dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit dhe atë: raporti i aksidentit i datës 24.02.2017, skica nga vendi i ngjarjes, fotodokumentacioni, mendimi



dhe konstatimi i ekspertit të mjekësisë ligjore mbi natyrën e lëndimeve për të dëmtuarin me numër reference 05/2017 i datës 16 Prill 2017 si dhe mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit rrugor i datës 21 Mars 2017 si dhe aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore apo faktike.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Por vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së sikurse me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale të kryer, ndërsa rrethan lehtësuese morri faktin se i akuzuari më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, moshën e re, kërkim faljen publike, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari ka bërë pranimin e fajësisë dhe ka shprehur pendim të thellë për këtë veprë të kryer, sjelljen e të akuzuarit në të kaluarën (se nuk ishte dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë më parë), sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, se ndihet i penduar thellë për këtë veprë të kryer, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të

KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm dhe në përshatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit e që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Në kuptim të nenit 463 par.2 të KPP-së, të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil, pasi që të dhënat e mbledhura gjatë procedurës penale nuk kanë paraqitur bazë për të vendosur në mënyrë të plotë e as të përsëritshme për kërkesën pasurore-juridike.


Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20/njëzet/€ si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej 60.88 /gjashtë dhjet euro e tetë dhjet e tetë cent/ €, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, P.nr. 985/17 datë 15.09.2017.**

Zyrtare ligjore,

**Kadishe Shabani**



Gjyqtari: Ilir BYTYQI



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.